



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 9 regjistër (JR)
Datë 13.02.2020

Nr. 40 i vendimit
Datë 22.12.2020

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Ardian Hajdari	Kryesues
Natasha Mulaj	Relatore
Albana Shtylla	Anëtare
Rezarta Schuetz	Anëtare
Sokol Çomo	Anëtar

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, më datë 22.12.2020, ora 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Steven Kessler, me Sekretare Gjyqësore Elba Arapi, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 9/2020, datë 13.02.2020, që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Agim Bendo, gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, i përfaqësuar sipas prokurës së posaçme me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 14.12.2020, nga Av. Boiken Bendo, me licencë nr. {***}.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 216, datë 04.12.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, Tiranë.

BAZA LIGJORE: Ligji nr. 84, datë 30.08.2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, neni 56, 57 e vijues; neni 64 e vijues i ligjit nr. 96, datë 06.10.2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 127/1, germa “c”, neni 139, pika 1 germa “c” dhe neni G i Aneksit të Kushtetutës.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore publike, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi shkaqet e ankimit dhe parashtrimet e subjektit të rivlerësimit nëpërmjet përfaqësuesit të tij ligjor, i cili kërkoi ndryshimin pjesërisht të vendimit nr. 216, datë 04.12.2019, duke hequr si të pabazuar urdhërimin në pikën 2 të dispozitivit të këtij vendimi, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes Natasha Mulaj, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, me vendimin nr. 216, datë 04.12.2019, vendosi:

- 1. Të deklarojë ndërprerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Agim Bendo, gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.*
- 2. Ndalimin e emërimit të z. Agim Bendo si gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare.*
- 3. Ky vendim u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.*
- 4. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të tij dhe duhet të dorëzohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.*

II. Shkaqet e ankimit

2. Kundër vendimit nr. 216, datë 04.12.2019, të Komisionit ka ushtruar ankim subjekti i rivlerësimit Agim Bendo, i cili kërkon ndryshimin pjesërisht të këtij vendimi, duke hequr si të pabazuar urdhërimin në pikën 2 të dispozitivit të tij, për të cilën parashtron shkaqet ankimore si më poshtë.

2.1 Subjekti pretendon se pjesa arsyetuese e vendimit të Komisionit nuk është e plotë dhe nuk pasqyron tërësisht realitetin e fakteve dhe provave, pasi shkak i vërtet i dorëheqjes nga statusi i gjyqtarit është dalja në pension pleqërie e subjektit të rivlerësimit në datën 06.09.2019, fakt i provuar nga akti i dorëheqjes me shkrim i datës 04.09.2019, si dhe aktet e tjera shkruese.

2.2 Subjekti i rivlerësimit pretendon se zbatimi i nenit G të Aneksit të Kushtetutës është keqinterpretuar dhe nuk mund të zbatohet në rastin e tij, pasi ka dalë në pension pleqërie.

III. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

3. Subjekti i rivlerësimit Agim Bendo, gjatë periudhës së fillimit të procesit të rivlerësimit kalimtar, ka ushtruar detyrën e gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Tiranë dhe, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio* në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
4. Çështja objekt gjykimi, mbi shqyrtimin e vendimit nr. 216, datë 04.12.2020, të Komisionit, që i përket subjektit të rivlerësimit Agim Bendo, u mor fillimisht në shqyrtim në dhomë këshillimi më datë 10.12.2020, nga ku u konstatua se vendimi i Komisionit është marrë mbi bazë dokumentesh, në dhomë këshillimi, pa zhvilluar një seancë dëgjimore me praninë e subjektit të rivlerësimit. Nisur nga ky fakt, edhe pse subjekti i rivlerësimit nuk ka ngritur asnjë shkak ankimor mbi procedurën e ndjekur nga Komisioni në lidhje me procesin e rregullt ligjor apo të drejtën për t' u dëgjuar, në kushtet kur vendimi përmban një ndalim apo humbjen e së drejtës sipas parashikimeve të nenit G të Aneksit të Kushtetutës, trupi gjykues, për të garantuar të drejtat procedurale të subjektit të rivlerësimit, në kuptim të procesit të rregullt ligjor, vendosi me vendim të ndërmjetëm shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore publike për t' i dhënë mundësinë subjektit të rivlerësimit të dëgjohet lidhur me zgjidhjen sa më të drejtë të kësaj çështjeje.
5. Lidhur me këtë vendim të ndërmjetëm, subjekti i rivlerësimit u njoftua rregullisht për gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike në datën 22.12.2020.
6. Gjatë shqyrtimit të çështjes në seancë gjyqësore publike në Kolegj, subjekti i rivlerësimit nuk ishte i pranishëm, por parashtrimet e tij u paraqitën në formë verbale nëpërmjet përfaqësuesit ligjor, sipas të cilit ishin të njëjta me ato të paraqitura në ankim, se shkak i dorëheqjes së subjektit ka qenë dalja në pension pleqërie, dhe zbatimi i nenit "G" të Aneksit të Kushtetutës është keqinterpretuar dhe nuk mund të zbatohet në këtë rast, duke konsideruar kështu si të pabazuar urdhërimin në pikën 2 të dispozitivit të vendimit.

IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit mbi shkaqet e ankimit lidhur me themelin e çështjes

7. Nga analizimi i akteve të administruara në dosjen gjyqësore, trupi gjykues konstaton se ndaj subjektit të rivlerësimit Agim Bendo ka filluar hetimi administrativ për procesin e rivlerësimit më datë 03.10.2018 dhe prej tij janë plotësuar dhe dërguar pranë Komisionit përgjigjet e pyetësorit nr. 1, më datë 14.10.2018, dhe përgjigjet e pyetësorit nr. 2, më datë 02.04.2019 dhe më datë 24.04.2019, shoqëruar me dokumentacion justifikues. Më datë 08.06.2019, subjektit të rivlerësimit i dërgohet pyetësori nr. 3 nga Komisioni.
8. Ka rezultuar nga hetimi gjyqësor se nga subjekti i rivlerësimit janë bërë një sërë kërkesash pranë Komisionit, me qëllim shtyrjen e afatit për kthimin e përgjigjeve të pyetësorit, për shkak të gjendjes jo të mirë shëndetësore dhe paaftësisë së përkohshme në punë të tij.

9. Më datë 04.09.2019, subjekti i rivlerësimit i është drejtuar Këshillit të Lartë Gjyqësor (në vijim “KLGj”), me kërkesë për deklarimin e mbarimit të statusit të gjyqtarit për shkak të dhënies së dorëheqjes, duke paraqitur dhe deklaratën “Për dorëheqjen nga puna (statusi) i gjyqtarit” drejtuar Këshillit të Lartë Gjyqësor, Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe Gjykatës së Apelit Tiranë.
10. KLGj-ja, me vendimin nr. 248, datë 04.11.2019, bazuar në nenin 61 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar dhe në nenet 64 dhe 65 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, pas shqyrtimit të kërkesës për heqjen dorë nga statusi i magjistratit, vendosi deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit për z. Agim Bendo, gjyqtar i Gjykatës së Apelit Tiranë, për shkak të dorëheqjes së tij nga ky status. Ky vendim i përcillet Komisionit me shkresën nr. {***} prot., datë 04.11.2019, dhe ndaj tij nuk është ushtruar ankim nga subjekti i rivlerësimit, siç konfirmohet nga Gjykata Administrative e Apelit, me shkresën nr. {***} prot., datë 25.11.2019.
11. Më datë 24.09.2019, nëpërmjet postës elektronike, subjekti i rivlerësimit dërgon pranë Komisionit kërkesën me objekt: “Për pushimin e procedurës së rivlerësimit për mua si subjekt rivlerësi, për shkak të paraqitjes nga ana ime të aktit me shkrim të dorëheqjes së përvokueshme nga detyra (statusi i gjyqtarit) që më datën 4 shtator 2019”. Në të njëjtën datë, subjekti dërgon edhe përgjigjet e pyetësorit nr. 3, shoqëruar me dokumentacion justifikues.
12. Referuar rrethanave të mësipërme, Komisioni, me vendimin nr. 216, datë 04.12.2019, bazuar në nenin G të Aneksit të Kushtetutës, si dhe në nenin 64 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, vendosi ndërprerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar për subjektin Agim Bendo, si dhe ndalimin e tij për t’u emëruar si gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm për një periudhë 15-vjeçare.
13. Subjekti i rivlerësimit në ankim dhe gjatë parashtrimeve në seancë gjyqësore publike nga përfaqësuesi i tij ligjor, kundërshton vendimin e Komisionit se mbarimi i statusit të magjistratit ishte për shkak të paraqitjes së dorëheqjes, pasi sipas tij arsytimi i përdorur nga Komisioni nuk është i plotë dhe nuk pasqyron shkakun e vërtetë të dorëheqjes që ka qenë dalja në pension pleqërie në datën 06.09.2019. Sipas subjektit, është i provuar juridikisht fakti i daljes në pension pleqërie që dy muaj përpara se Këshilli i Lartë Gjyqësor të merrte vendimin për deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit dhe 3 muaj përpara se Komisioni të merrte vendimin nr. 216, datë 04.12.2019.
14. Trupi gjykues i Kolegjit, me qëllim identifikimin e shkakut të mbarimit të statusit të magjistratit dhe vullnetit të subjektit për dorëheqjen nga detyra e gjyqtarit, nga analizimi i kërkesave të subjektit drejtuar KLGj-së dhe Komisionit, të administruara në dosjen gjyqësore, konstaton sa më poshtë vijon.

14.1 Në deklaratën e datës 04.09.2019, “Për dorëheqje nga puna (statusi) i gjyqtarit”, drejtuar KLGj-së, Komisionit dhe Gjykatës së Apelit Tiranë, subjekti shprehet: [...] *deklaroj se, në zbatim të nenit 65 të ligjit nr. 96, datë 06.10.2016, ndryshuar me ligjin nr. 48, datë 18.07.2019) – jap dorëheqjen e parevokueshme nga vazhdimi i mëtejshëm i punës si gjyqtar (pra statusi i gjyqtarit) për arsye se në datën 6 shtator 2019 unë mbush moshën 65 vjeç, kufi moshe ky mbi bazën e të cilit, unë i jam drejtuar Sigurimeve Shoqërore për të më llogaritur dhe akorduar pensionin e pleqërisë në bazë të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 [...]. Gjithashtu [...] gjendja ime shëndetësore është mjaft e rënduar, saqë këta 3 muajt e fundit kam qenë i detyruar të qëndroj në shtëpi në kushtet e paaftësisë së përkohshme për punë.*

Theksoj se momenti i mbushjes së moshës 65 vjeç për daljen në pension, si dhe vjetërsia ime në punë prej 43 vjetësh, më japin të drejtën ligjore për të dalë në pension duke u dorëhequr nga puna si gjyqtar dhe duke mos e çuar statusin e gjyqtarit deri në fund d.m.th. deri në moshën 67 vjeç që parashikon neni 64 i ligjit nr. 96, datë 06.10.2016 [...].

14.2 Në kërkesën e datës 04.09.2019, drejtuar KLGj-së, për dijeni Komisionit dhe Gjykatës së Apelit Tiranë, subjekti shprehet: [...] *lutemi që nga ana juaj si organ kompetent ligjor të deklarohet mbarimi i statusit tim të gjyqtarit, sikurse është sanksionuar në nenin 64, pika 1, germa “a” dhe nenin 65, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 96, datë 06.10.2016 [...].*

14.3 Në kërkesën e datës 24.09.2019, dërguar Komisionit, për pushimin e procedurës së rivlerësimit për shkak të paraqitjes së dorëheqjes së parevokueshme nga detyra (statusi i gjyqtarit) që më datë 4 shtator 2019, subjekti shprehet se: [...] *në këtë aspekt vëmë në dukje se nga pikëpamja ligjore neni 65/2 i ligjit nr. 96, datë 06.10.2016 [...] nuk kërkon domosdoshmërisht paraqitjen e shkaqeve për të qenë i vlefshëm, por megjithatë parashtrimi i këtyre shkaqeve nga ana ime në aktin e dorëheqjes është bërë për të qenë sa më korrekt si subjekt i rivlerësimit ndaj jush si organ, KLGj-së dhe Gjykatës së Apelit.*

Në këto rrethana, duke u bazuar në nenin 56 të ligjit nr. 84, datë 30.08.2016 [...], si dhe në akt dorëheqjen me shkrim të datës 4 shtator 2019 [...] për dorëheqjen e parevokueshme nga puna si gjyqtar (statusi i gjyqtarit) – kërkoj që nga ana juaj si Komision i Pavarur i Kualifikimit të vendoset pushimi i procedurës së rivlerësimit [...].

- 15.** Për sa më sipër, edhe pse subjekti i rivlerësimit bashkëlidhur ankimit, si dhe gjatë seancës gjyqësore publike depozitoi dy dokumente në cilësinë e provës: i) kopje të librezës së pensionit të lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë, datë 06.09.2019, dhe ii) vërtetim nr. {***} prot., datë 15.10.2019, të po kësaj drejtorie, sipas të cilit subjekti i rivlerësimit merr pension pleqërie nga data 06.09.2019, trupi gjykues i Kolegjit i konsideron akte të cilat provojnë fakte të parëndësishme për marrjen e vendimit, në përputhje me nenin 49, pika 6, germa “b” e ligjit nr. 84/2016. Vetë baza ligjore mbi të cilën subjekti i rivlerësimit ka mbështetur kërkesat e tij, konkretisht neni 64, pika 1, germa “a”¹, neni 65 pikat 1 dhe 2² të ligjit nr. 96/2016 dhe neni 56 i ligjit nr. 84/2016 provojnë faktin se ndodhemi në kushtet e institutit të dorëheqjes nga detyra (statusi i magjistratit) të subjektit të rivlerësimit.

¹ Neni 64, pika 1: “Statusi i magjistratit mbaron në rastet kur: a) jep dorëheqjen [...]”.

² Neni 65: “1. Magjistrati mund të kërkojë mbarimin e statusit, nëpërmjet paraqitjes së dorëheqjes para Këshillit përkatës. 2. Dorëheqja duhet të jetë me shkrim dhe nuk është e nevojshme të jetë e arsyetuar. Dorëheqja jep efektet në fund të muajit pasardhës, nga dita kur Këshilli merr deklarinimin me shkrim të dorëheqjes. Mbarimi i statusit të magjistratit deklarohet me vendim të Këshillit jo më vonë se dy javë nga mbarimi i statusit”.

16. Në vijim të këtij arsytimi, trupi gjykues i Kolegjit e gjen të pabazuar pretendimin e subjektit se pjesa arsyetuese e vendimit të Komisionit nuk pasqyron tërësisht realitetin e fakteve dhe provave, sipas të cilit shkak i vërtetë i dorëheqjes nga statusi i gjyqtarit është dalja në pension pleqërie e subjektit të rivlerësimit, ndërkohë që vetë kërkesat e subjektit për dorëheqjen nga statusi i magjistratit apo për pushimin e procesit të rivlerësimit mbështeten në dispozitat ligjore që i njohin subjektit të drejtën për t'u dorëhequr nga detyra (statusi i magjistratit).
17. Trupi gjykues, duke mbajtur parasysh dhe jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit, arsyeton se dorëheqja nga statusi i magjistratit, në kuptim të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, sjell për pasojë edhe humbjen e cilësisë si subjekt rivlerësimi *ex officio* në kuadër të përcaktimit kushtetues të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës dhe pamundësinë për të vazhduar procesin e rivlerësimit. Trupi gjykues arsyeton se në momentin që subjekti i rivlerësimit, me vullnetin e tij të lirë ndërpret detyrën e gjyqtarit që e bën atë subjekt të procesit të rivlerësimit *ex officio*, duhet të marrë parasysh edhe pasojën ligjore që sjell dorëheqja nga detyra në ecurinë e procesit të rivlerësimit, sipas nenit G të Aneksit të Kushtetutës.
18. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në kuadër të procesit të rivlerësimit, në rastet kur subjektet e rivlerësimit heqin dorë nga detyra përgjatë procesit të rivlerësimit, si në rastin konkret, ka urdhëruar aplikimin e nenit G të Aneksit të saj, ku shprehimisht përcaktohet:
1. Subjekti i rivlerësimit mund të japë dorëheqjen nga detyra dhe në këtë rast procesi i rivlerësimit ndërpritet. 2. Subjekti i rivlerësimit që dorëhiqet sipas kësaj dispozite, nuk mund të emërohet gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare. Të njëjtin qëndrim ka mbajtur edhe Gjykata Kushtetuese në vendimin e saj nr. 78, datë 12.12.2017, ku arsyeton se: Gjykata thekson se për sa kohë që subjekti i rivlerësimit është në detyrë dhe procesi i rivlerësimit nuk ka përfunduar ende, ai ka të drejtën të japë dorëheqjen dhe në këtë rast procesi i rivlerësimit ndërpritet, duke u zbatuar parashikimet e nenit G të Aneksit të Kushtetutës.
19. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson të drejtë zbatimin e nenit G të Aneksit të Kushtetutës nga ana e Komisionit, duke vendosur ndalimin e subjektit nga e drejta për t'u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare, siç parashikohet në pikën 2 të dispozitivit të vendimit nr. 216, datë 04.12.2019.
20. Trupi gjykues, pasi analizoi shkaqet e ankimit, parashtrimet e subjektit të rivlerësimit nëpërmjet përfaqësuesit ligjor të tij dhe provat e administruara në dosjen gjyqësore, çmon se ndodhemi para mbarimit të statusit të magjistratit të subjektit të rivlerësimit Agim Bendo, për shkak të dorëheqjes nga detyra e gjyqtarit. Për rrjedhojë, trupi gjykues gjen të drejtë dhe të bazuar në ligj vendimin e Komisionit në pikën 2 të dispozitivit të tij, që parashikon ndalimin e subjektit të rivlerësimit për t'u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare, sipas parashikimeve të nenit G të Aneksit të Kushtetutës.

21. Në përfundim, trupi gjykues i Kolegjit çmon se vendimi i Komisionit për zbatimin e nenit G të Aneksit të Kushtetutës është i drejtë, i bazuar në fakte dhe në ligj dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin G të Aneksit të Kushtetutës, në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 216, datë 04.12.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Agim Bendo.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 22.12.2020.

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

RELATORE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

KRYESUES

Ardian HAJDARI

nënshkrimi